



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

Informacion i përmbledhur i veprimtarisë gjyqësore¹

1. Lidhur me kushtet e veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal, nga vendimmarrja e gjyqtarit të hetimeve paraprake nuk ka ndryshuar asgjë, dhe gjyqtari i seancës paraprake nuk ka sjellë ndonjë element të ri që tregon mungesën e kushteve të veçanta si rreziku i ikjes dhe rreziku i dëmtimit të provave.

Vendimi i gjyqtarit të hetimeve paraprake (lidhur me caktimin masës së sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”), i ka kaluar të tre shkallët e gjykimit madje dhe Gjykatën Kushtetuese dhe është konfirmuar.

Ndërkohë, masa e sigurimit “*Arrest në shtëpi*” është vendosur jo për shkak të shtimit të nevojave të sigurimit por për shkak të thyerjes së detyrimeve të masës së mëparshme të sigurimit, ajo e “*Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”.

Kërkuesi z. S.B. e ka tentuar duke paraqitur edhe më parë pranë gjyqtarit të hetimeve paraprake, kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit personal, ku e tillë kërkesë është rrezuar me vendim të konfirmuar në të tre shkallët e gjykimit.

Si rezultat, nuk ka vend për shuarjen e masës së sigurimit personal.

Gjyqtari i seancës paraprake në marrjen e vendimit të tij, thjesht ka bërë një rivlerësim të elementëve që janë marrë një herë në konsideratë nga gjyqtari i hetimeve paraprake, pa shtuar ndonjë element të ri, gjë e cila nuk i lejohet pasi përbën gjë të gjykuar.

2. Lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga ajo e “*Arrest në shtëpi*” në “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, duke marrë parasysh:

- faktin se kërkuesi kishte një vit me masën e sigurimit “*Arrest në shtëpi*”,

- faktin se moszbatimi i detyrimeve që lidheshin me masën e sigurimit “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*” bazoheshin mbi një alibi për antikushtetueshmërinë e kësaj mase, të rrezuar tashme nga Gjykata Kushtetuese,

- moshën dhe rrethana e tjera që kanë qenë në konsideratë të gjyqtarit të hetimeve paraprake, por të vlerësuara tashmë në raport me këto rrethana të tjera,

- si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që jemi në periudhën para fushatës zgjedhore dhe kërkuesi është konsideruar edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese si lideri i opozitës, ose kryetar i partisë kryesore opozitare,

u arrit në përfundimin që masa e sigurimit “*Arrest në shtëpi*” nuk ishte më e nevojshme.

Me anë të kësaj mase (“*Arrest në shtëpi*”) kërkuesi e ka shlyer në një farë mënyre pasojën e dhënë nga dispozitat ligjore për moszbatimin e masës së mëparshme të sigurimit “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, dhe për rrjedhojë kjo masë siguri duhej zëvendësuar, duke i’u dhënë edhe një herë mundësia kërkuesit që të respektojë detyrimet që lidhet me masën e re të sigurimit “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”.

Ne rast se kërkuesi nuk do të zbatojë detyrimet që lidhen me masën e sigurimit “*Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, atëherë organi i akuzës do të ketë të drejtën të kërkojë serish zëvendësimin e kësaj mase siguri, me një masë siguri më të rëndë.

¹ Vendimi nr. 1, datë 03.01.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.